



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Limani Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë
Tel: +355 69 600 3707 Email: secretary.general@nocalbania.org.al <https://nocalbania.org.al>

Tiranë më, 22.09.2022

THIRRJE PUBLIKE

LËNDA: Thirrje për Anëtar Themelues të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS)

I/e nderuar,

KAS është një institucion arbitrazhi, i cili organizohet dhe funksionon në bazë të Rregullores së miratuar nga Asambleja e KOKSH më datë 28.05.2022, ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", legjislacionin e zbatueshëm procedural dhe material shqiptar dhe Konventat dhe Traktatet mbi Sportin.

Sipas **Nenit 6** të Rregullores së Këshillit të Arbitrazhit Sportiv, KAS do të themelohet nga 3 anëtarë themelues të cilët do të jenë dhe anëtarët e parë të organit më të lartë vendimmarrës që do të jetë Bordi Ekzekutiv.

Anëtarët themelues të KAS do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e KOKSH ndërmjet:

- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar nga Federatat Sportive;
- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar Komisioni i Sportistëve të KOKSH- it;
- 1 anëtar nga të paktën 1 kandidat të propozuar nga thirrja publike.

Objekti i kësaj thirrje publike është dërgimi në Asamblenë e KOKSH i kandidaturave nga publiku i gjërë për të zgjedhur një anëtar themelues të KAS.

Anëtarët themelues të KAS për t'u emëruar duhet të plotësojnë **kriteret e mëposhtme:**

- a) Të kenë arsim të lartë juridik dhe të paktën 12 (dymbëdhjetë) vjet përvojë në fushën e së drejtës, si juristë, avokatë, arbitër, pedagogë të fakulteteve të drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës apo magjistratë. Këta të fundit nuk duhet të jenë magjistratë në detyrë dhe të mos jenë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore.
- b) Të zotërojnë njohuri në të drejtën e sportit;
- c) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- d) Të mos jenë anëtarë të partive politike;
- e) Të mos jenë shkarkuar nga detyrat e mëparshme apo të mos iu jetë hequr leja e ushtrimit të profesionit për shkaqe disiplinore

** Kandidatët për anëtarë themelues të KAS do të verifikohen nga Komisioni i Verifikimeve dhe Etikës (në vijim referuar si "KVE") për plotësimin e kriterëve si më lart, përpara se Asambleja*



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Limani Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë
Tel: +355 69 600 3707 Email: secretary.general@nocalbania.org.al <https://nocalbania.org.al>

e Përgjithshme të marrë një vendim për zgjedhjen e tyre. KVE zbaton të njëjtën procedurë të parashikuar në statutin e KOKSH për zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv.

Për të dërguar kandidaturat tuaja ju lutem ndiqni hapat më poshtë.

Për secilin Kandidat që propozohet, kërkohet:

1. CV (Curriculum Vitae);
2. Kopje e pashaportës së Republikës së Shqipërisë;
3. Kopje e diplomës Universitare;
4. Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore (dëshmia e penalitetit)
5. **Vetëdeklarim i noterizuar** në të cilin kandidati deklaron me përgjegjësi të plotë përpara ligjit se:
 - Kandidati është dakord të propozohet/kandidojë si anëtar themelues i KAS;
 - Ka vendbanim/vendqendrim të përhershëm në Shqipëri;
 - Ka arsim të lartë juridik dhe të paktën 12 (dymbëdhjetë) vjet përvojë në fushën e së drejtës, si juristë, avokatë, arbitër, pedagogë të fakulteteve të drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës apo magjistratë;
 - Zotëron njohuri në të drejtën e sportit;
 - Zgjedhja e tij/saj si anëtar themelues dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të KAS nuk krijon asnjë konflikt interesi me aktivitetet e tjera me të cilat kandidati/ja është i/e përfshirë;
 - Ka një reputacion shoqëror dhe moral të pacenuar, nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje dhe përfshirja në KAS nuk do çenonte reputacionin e KAS-it;
 - Nuk është anëtar/e i partive politike;
 - Nuk është shkarkuar nga detyrat e mëparshme apo nuk i është hequr leja e ushtrimit të profesionit për shkaqe disiplinore;

Për referencë, ju lutem gjeni rregulloren e KAS **KETU**.

Në mënyrë që kandidaturat të jenë të vlefshme dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë KOKSH ose në adresën secretary.general@nocalbania.org.al brenda datës **7 Tetor ora 17:00**, me subjektin **“Aplikim për Anëtar Themelues të KAS”**.